

Ju ofrojmë këshillime

Të hënën - premtën prej ora 9-14

Danezisht dhe anglisht
Tlf. 33 73 50 00

Në numrat mëposht - përveç danezisht - këshillojmë
edhe në gjuhët

Boshnjakisht / serbisht / kroatisht
33 73 52 33

Arabisht dhe kurdisht (sorani)
33 73 52 28

Somalisht
33 73 53 11

Urdu dhe punxhabe
33 73 52 05

Nëse dëshironi këshilla konkrete individuale
për të drejtat tuaja në lidhje me kthimin në atdhe, duhet të
plotësoni një formular për të dhënat tuaja, që mund ta gjeni
në faqen tone.

www.atvendehjem.dk

Mund edhe të shkruani në
atvendehjem@drc.ngo



PËR RIATDHESIM 2024

Informata për refugjatë, imigrantë, dhe
persona me dy nënshtetësi për kthim
vullnetarisht në atdhe

NËSE MENDON TË KTHEHENI NË VENDLINDJE

Ndihma Daneze për Refugjatëve ofron këshillime për qytetarë që kthehen vullnetarisht në vendlindje, ose në një shtet ku keni lidhje të ngushta familjare. Refugjatë, imigrantë, dhe persona me dy shtetësi (një nënshtetësi daneze dhe një tjetër), kanë mundësi të marrin mbështetje financiare me vete, nëse ato kthehen në atdhe. Për të marrë ndihmë, varet se kur keni ardhur në Danimarkë dhe çfarë lloji leje qëndrimi keni.

Nëse doni të dini, a keni të drejtë për ndihmë financiare, nëse ktheheni në atdhe, duhet të na dërgoni një formular me të dhënat tuaja në www.atvendehjem.dk.

NDIHMË EKONOMIKE

Në vitin 2024 të riturit kanë mundësi të marrin ndihmë deri në 155.417 kr. për të filluar një jetë të re në vendlindje. Fëmijët kanë mundësi të marrin deri më 47.401 kr.

Paratë paguhen në dy pjesë – pjesa e parë paguhet në lidhje me udhëtimin (deri më 62.166 kr. për të rritur, deri më 18.960 kr. për fëmijë) dhe pjesa e dytë (deri më 93.251 kr. për të riturit, deri më 28.441 kr. për fëmijë) ju paguhet pasi të keni qëndruar një vit të plotë në atdhe.

OPSIONE SHITESË PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

- Shpenzimet e udhëtimit
- Transporti i gjërave tua ose ndihmë për shpenzimet për blerëjen e gjërave personale,
- Pajisjet e profesionit të punës dhe transporti i pajisjeve,
- Sigurim shëndetsor / kostot e trajtimit der 4 vjet,
- Ilaçe për 1 vit konsumim,
- Mjete ndihmëse të domosdoshme,
- Shpenzime për shkollim deri në 4 vite për fëmijet të moshës 5-16 vjet
- Ndihmë për pajisje me dokument udhëtimi.

NËSE KE MBUSHUR 55 VJET

Nëse i keni së paku 55 vjet momentin kur të riatdhesoni, mund të ju paguhet edhe një shumë e përhershme për çdo muaj si ndihmë financiare nga Danimarka.

Nëse jeni mes 50 dhe 54 vjet, mund nën kushte të veçanta të paguhet shuma e të hollave. Ndihma është zakonisht mes 2.800 kr. dhe 3.600 kr. në muaj. Për të përfituar këtë të drejt, duhet të keni pas leje qëndrimi në Danimarkë të paktën 5 vjet.

Nëse ka ndonjë marrëveshje bilaterale mes Danimarkës dhe vendlindjes tuaj, ka mundësi që të merreni një pjesë të penzionit tuaj me vete në vendlindje.

E DREJTA PËR T'U TËRHEQUR

Refugjatët kanë të drejtë për ta tërhequr vendimin për t'u kthyer në vendlindje dhe të kthehen përsëri në Danimarkë zakonisht brenda 1 viti. Kjo do të thotë, se ato përsëri mund të arrin lejen e qëndrimit në Danimarkë. Por ato obligohet që ta kthejnë prapë shumën e ndihmës të riatdhesimit, nëse tërhiqen prej riatdhesimit.

Imigrantët nuk kanë të drejt të kthehen përsëri në Danimarkë, pasi ato kanë udhëtuar dhe kanë marrë ndihmë për tu kthyer në vendlindje. Për ato vendimi është përfundimtar dhe një lamtumirë për të drejtat, që ato kanë pas gjatë qëndrimit në Danimarkë.

Qytetarët me dy nënshtetsi duhet pjesërisht të heqin dorë nga nënshtetësia daneze para udhëtimit. Ato kanë të drejtë të tërheqin vendimin e marë, për dorëzimin e nënshtetësisë daneze deri dy vjet. Nëse ato e tërheqin riatdhesimin duhet ta kthejnë prapë shumën e ndihmës për atdhesim.

NËSE DONI TË DINI MË SHUMË

Nëse mendon të kthehesh në atdhe, mund të na dërgoni një formular me të dhënat tua, të cilën mund ta gjeni në web faqën tonë. Në një bisedë individual do të ju informojmë për mundësitë dhe të drejtat tua, kështu që të merrni një vendim. Do të ju ofrojmë një përkthyes, nëse dëshiron. Detyra jonë është për të dhënë informata, të cilat ti ke nevojë për të marrë vendimin tënd.